



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 21

Datë: 10. 04. 2020. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

- Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të KQZ-së për vitin 2021-2023;

3. Të ndryshme.

(p.s. Kjo mbledhje, për arsye të pandemisë Kovid – 19, realizohet në mënyrë teknologjike, përmes sistemit “Skype” – Internet)

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Po fillojmë me mbledhjen e 21-të, a ka dikush vërejtje në rendin e ditës...? Nuk ka. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ. E kemi në rend dite këshillin për buxhet. Ju lus që në pika të shkurtëra të referoni, në materialin e kemi të gjithë në imell...

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të KQZ-së për vitin 2021-2023;

Sami Hamiti: Përshëndetje. Sot e kemi mbajtur mbledhjen e 7-të të këshillit, dhe e kemi shqyrtuar të vetmen pikë të rendit të ditës: “Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të KQZ-së për vitin 2021-2023”. Sigurisht, e dini që dje e kemi marrë një draft paraprak, dhe sot, po ashtu, menaxhmenti është takuar edhe njëherë dhe, tani kemi një dokument të ri. Janë rishikuar disa pozicione, dhe buxheti është reduktuar me rreth 700 mijë euro. Mendoj që, ka qenë kohë e shkurtër, por duke e parë që kemi një kornizë, në planifikim të saj në qershor mund të kemi një planifikim më të mirë, si në aspektin përshkrues dhe po ashtu në atë narrativ. Në konsultim me krye shefin, do të ketë një strukturim të stafit permanent dhe jo permanent, përmes një projekti që do të realizohet së bashku me OSBE, atëherë do të kemi një pasqyrë më të qartë të buxhetit.

Me këto analiza, KBF, rekomandon që korniza të votohet, dhe të ecim tutje...

Valdete Daka: A ka dikush të shtoj rreth këtij rekomandimi...?

Alim Rama: Ka pasur mjafto diskutim në takimin e këshillit, dhe unë ende qëndrojmë ndaj asaj se korniza ka pasur hapësirë të punohet më mirë! Për shembull: në dokument – aty ku teksti është me narracion, potencohet fakti që investimet e kapitale të shkojnë në softvera, në përgjithësi për avancimin e shërbimit për votuesit në QNR dhe shërbimet e tjera! Por, kjo nuk është e paraparë në kornizën buxhetore. Unë, sugjeroj të ketë amendamentimin të kësaj kornize, ku parashihen vlerat e sakta ose të përafërta...

Yll Buleshkaj: Është ashtu si u prezantua, por kjo duket se është di proporcionale për shkak se, viti i ardhshëm është vit zgjedhor, dhe pjesa më e madhe e fondeve shkon për shpenzime të stafit. Por, aty janë të parapara edhe shpenzimet për

teknologjinë informative. Po ashtu, projektet kapitale të këtij viti nëse ministria nuk na i aprovon, atëherë të gjitha këto do të barten në vitin tjetër si pjesë e buxhetit...Është e vërtetë: sapo të kemi kohë, do të jemi më të detajshëm! Mirëpo, në proporcion me planifikimet dhe nevojat, kjo nuk është në disproporcion...

Mundemi me bërë më shumë, por nuk mundemi me qenë shumë të saktë sepse, nuk e dimë se sa projekte mund t'i realizojmë. Për më tepër, në këtë vit ne kemi planifikuar edhe hartimin e planit strategjik, si një bazë e mirë për të ardhmen, ndërsa kjo që e kemi paraqitur sot në këtë fazë, edhe mund të ndryshohet...

Eshref Vishi: Në kushtet që është punuar, ky dokument nuk ka mundur të jetë më i mirë, dhe pajtohem me raportimin nga Samiu, sepse në qershor fillon procesi i planifikimit të buxhetit për vitin 2012, e ku përcaktohet lartësia dhe kufijtë buxhetor për vitin pasues...U përmend që është reduktuar buxheti rreth 700 mijë euro, do t'ishte mirë ta dimë se në cilat kategori është reduktuar...!?

Sami Hamiti: Pak është vështirë me i idenfikuar shpejt këto reduktime, sepse edhe materialin e keni marrë në kohë të shkurtër...Unë, sot isha në KQZ dhe, dhe kemi qenë në kontakt: e para, është reduktuar afat për stafin jo permanent që të mos jenë gjashtë muaj, por dy – tre muaj, dhe do të reduktohen ende...! Ka zvogëlim të materialeve të Informimit Publik, te materialet e tjera zgjedhore...

Valdete Daka: Edhe unë e pashë materialin, por kjo është një kërkesë që ta dërgojmë: sot, deri në orën 16:00. Jemi në kushte të jashtëzakonshme, të gjithë po punojmë në këto kushte, dhe besoj që edhe gabimet eventuale mund të korrigjohen në qershor, dhe të gjitha këto që u thanë...

Pra, po e hedh në votim! Më duke jemi 10 anëtarë, sepse Sami Kurteshi, u largua nga skype! Pra, nuk është në takim... Kush është për...?

Antarët e KQZ votuan draftin me 9 vota për, dhe me një votë kundër (Alim Rama).

Valdete Daka: E lus sekretariatit që t'ia prezantoj dokumentin Ministrisë së Financave...

3. Të ndryshme.

Alim Rama: Në takimin e kaluar, a mund të kemi informacion se cka është aprovuar, dhe cka jo...?

(Më tej, nuk ka incizim...)